NJOFTIM:

Bashkia Elbasan në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, dhe të Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 132 datë 02.11.2026 *"Mbi miratimin e nisjes së proçedurave për marrjen me qira të një ambjenti (strehëz emergjence) për Forumin e Gruas Elbasan",* në vijim të Proçes Verbalit nr.5283/7 datë 20.11.2026, me të cilin u konstatua mbyllja e afatit të parë pa asnjë ofertë të paraqitur, njofton shtyrjen e afatit të dorëzimit të ofertave për marrjen me qira një ambjenti/apartamenti (2 dhoma + 1 guzhinë + tualet), të përshtatshëm për gratë dhe vajzat e mbijetuara nga dhuna në familje, me një fond deri në 30 000 lekë/muaj. Ambjenti/apartamenti preferohet me vendndodhje pranë institucioneve të Rendit e Shërbimit Publik dhe të pajiset me sistem alarmi. Të gjithë subjektet privatë të interesuar, janë të lutur të paraqesin ofertat ku të përfshihet:

- *Ofertë për dhënie me qira;*
- *Vlera e qirasë mujore;*
- *Çertifikatë regjistrimi (NUIS), ekstrakt historik;*
- *Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore vendore dhe rajonale;*
- *Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria;*
- *Dokument pronësie (i rifreskuar);*
- *F/kopje dokument ID;*
- *Foto të ambjentit;*

Ofertat dorëzohen me zarf të mbyllur pranë zyrë së Protokollit të Bashkisë.
Afati i ri i pranimit të ofertave është data 27.11.2026 ora 09 ^{00}.
Hapja e ofertave do të bëhet në datën 27.11.2026, ora 11 ^{00}, në godinën e Bashkisë Elbasan.
Gjithashtu, Ju njoftojmë se, pas hapjes së ofertave, komisioni i vlerësimit do të bëjë verifikimin e ambjenteve që janë paraqitur në ofertë, prandaj kërkojmë disponueshmërinë tuaj.

Faleminderit!